

VENDIM
Nr. 341, datë 22.4.2015

**PËRSHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVETË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI
I BULEVARDIT “OSUMI”, FAZA E PARË, NË BASHKINË E BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, për rikonstrukcionin e bulevardit “Osumi”, faza e parë, në Bashkinë e Beratit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Beratit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, sipas vlerës përkatëse për sipërfaqen prej 87 (tetëdhjetë e shtatë) m², “ndërtesë”, në vlerën e përgjithshme 2 830 197 (dy milionë e tetëqind e tridhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 2 830 197 (dy milionë e tetëqind e tridhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Beratit, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Beratit.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë e Beratit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 87 (tetëdhjetë e shtatë) m², “ndërtesë”, për rikonstrukcionin e bulevardit “Osumi”, faza e parë, të bëhet në favor të Bashkisë së Beratit.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat dhe Bashkia e Beratit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN
"PËR RIKONSTRUKSIONIN E BULEVARDIT OSUMI, FAZA E PARË"
BASHKIA BERAT

Nr	Emri,mbiemri	Zona kadastrale	Ndërtesë sip/m ²	Çmimi/lekë	Vlefte/lekë	Nr. kadastral	Zëri kadastral	Lloji i dokumentit
1	Niazi Sherif Ajazi	8502	87	32 531	2 830 197	11/5.	Ndërtesë	Vërtetim pronësie
	Totali				2 830 197			